REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 13/23
Datë/Datum. 16.01.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë. Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 13/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 paragrafi 3 sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik (OE) "Dezinfektimi AD" Prishtinë , për aktivitetin e prokurimit me titull: " Shërbimet e Pastrimit te Brendshëm në Spitalin e Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1 ", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Spitali i Përgjithshëm Gjilan , Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj - Mexhuani me datën: 13 janar 2023 mori këtë:

VENDIM

Hedhet si e pa lejuar ankesa e datës 05.01.2023 (protokoll 13/2023) e OE "Dezinfektimi AD" Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull: " Shërbimet e Pastrimit te Brendshëm në Spitalin e Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1 ", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Spitali i Përgjithshëm Gjilan.

I lejohet autoritetit kontraktues – Spitali i Pergjithshem Gjilan , që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e Pastrimit te Brendshëm në Spitalin e Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1 ", përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankese tjetër .

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 05.012023 , ka pranuar ankesë nga OE "Dezinfektimi AD" Prishtinë , për aktivitetin e prokurimit me titull "për aktivitetin e prokurimit me titull: " Shërbimet e Pastrimit te Brendshëm në Spitalin e Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1 ", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Spitali i Përgjithshëm Gjilan, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 13/2023

Për aktivitetin prokurimit të cekur si më lart autoriteti kontraktues me datën 18.10.2022, ka publikuar B05 Njoftimi për Kontrate me dosjen e tenderit , ku ne baze te këtyre dëshmive afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 16.11.2022.

Pasi që për aktivitetin e prokurimit në fjalë kundër njoftimit te lartcekur AK kishte pranuar kërkesë për rishqyrtim nga OE brenda afateve ligjore , AK kishte pranuar dhe shqyrtuar kërkesën e OE dhe kishte marr vendim për kërkesën në fjalë.

I pa kënaqur me ketë vendim te AK-së OE në fjalë me datën :16.11.2022 kishte ushtruar ankesë ne OSHP ankese kjo qe ishte protokolluar nga OSHP me numër 664-2022.

OSHP me datën 15.12.2022 kishte marr vendim me te cilin kishte aprovuar ankesën e lartcekur dhe kishte obliguar AK-ne qe te bej korrigjimet e dosjes se tenderit .

AK pas pranimit te vendimit te OSHP-së për ankesën e lartcekur kishte publikuar Njoftimin e ri B05 Formular Standard për korrigjim te njoftimit me datën 23.12.2022, ku sipas këtij Njoftimi afati i fundit për ofertim për aktivitetin e prokurimit në fjalë ishte specifikuar data 05.01.2023.

Me datën 04.01.2023 ora 00:09h OE "Dezinfektimi AD" Prishtinë , kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit B05 dhe dosjes së tenderit te publikuar me datën 23.12.2022.

Me datën 04.01.2023,ora 14:14h AK merr vendim me te cilin e refuzon kërkesën e OE te cekur si me lart.

Kundër këtij vendimi OE me datën 05.01.2023, parashtron ankesë në OSHP (protokoll 13/2023).

AK me te pranuar ankesën e lartcekur i drejtohet OSHP-së me këto sqarime : "Te nderuar sot me datën 05.01.2023 kemi pranuar një ankesë nga operatori ekonomik për aktivitetin e prokurimit 220-70001-0731-22-11333-2-1-1 Titull " Shërbimet e Pastrimit te Brendshëm ne Spitalin e Përgjithshëm Gjilan. Operatori Ekonomik ka bere kërkesë për rishqyrtim me datën 04.01.2023 te pas afatshme sepse kërkesa për rishqyrtim duhet te dorëzohet 5 dite para hapjes se ofertave duke u bazuar ne ligjin e prokurimit publik. Te bashkangjitur gjeni te gjitha dëshmitë lidhur ketë ankesë te pa bazuar. Kërkojmë qe aktivitet i prokurimit te lirohet dhe te zhvillohen procedurat e prokurimit ankesa e OE te hedhet se e pas afatshme".

Nga zyrtarja pre të hyra në OSHP jemi njoftuar se për ankesën e lartcekur OE në fjalë nuk ka deponuar fare tarifën e sigurimit të ankesës deri me sot date 10.01.2023.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vlerësohet se OE ankues ka humbur afatin ligjor për parashtrim të

kërkesës për rishqyrtim sepse në bazë te njoftimit B05 të datës 23.012.2022, dhe dosjes së tenderit të po kësaj date afati i fundit për dorëzimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë ka qenë data 05.01.2023, kurse kërkesë për rishqyrtim nga OE ankues është parashtruar në AK me datën 04.01.2023, ora 00:09h

Sqarojmë se duke pas parasysh faktin se ankesa e OE në fjalë është ushtruar kundër Njoftimit për kontrate –dokumenteve te dosjes së tenderit në pajtim me nenin 108/A në të LPP-së ankuesi ka mundur te parashtroj kërkesë për rishqyrtim brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave, e jo ankesën e tij ta ushtroj një ditë para afatit te fundit për dorëzim të ofertave.

Nga sqarimet e dhëna si më lart konstatohet se OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim 1/një, ditë para hapjes së ofertave, e jo siç specifikohet në paragrafin 3 pika 1 të nenit 108/A te LPP-së: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart konstatohet se ankesa e parashtruar në OSHP ,me date 05.01.2023(protokoll 13/2023) nga OE "Dezinfektimi AD" Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull: " Shërbimet e Pastrimit te Brendshëm në Spitalin e Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit: 220-70001-0731-22-11333-2-1-1 ", iniciuar nga (AK) Spitali i Përgjithshëm Gjilan, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar në kundërshtim me paragrafin 3 pika 1 të nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4 "Rregullave Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK – Spitali i Përgjithshëm Gjilan
1x1 OE "Dezinfektimi AD" SH.P.K. Prishtinë,
1x1 Arhivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së